




INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS



SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCË, COVID-19 DHE PATOGENËT TJERË RESPIRATORË NË KOSOVË, SEZONA 2025/2026 (JAVA 20-TË)

Simptomet e Gripit përfshijnë:

- Temperaturë/ethe
- Kokëdhimbje
- Lodhje
- Kollë e thatë
- Dhimbje fyti
- Rrjedhje hundësh
- Dhimbje muskulare
- Simptome gastrointestinale, si nauze dhe barkqitje




PËRMBLEDHJE

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike gjatë tërë vitit bën mbikëqyrjen permanente të Influcencës sezonale (ILI), ARI dhe SARI me intensifikim të aktiviteteve gjatë sezonës përkatëse. Mbikëqyrja realizohet përmes hulumtimit aktiv dhe pasiv në institucione shëndetësore dhe terren.

**SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË,
2021/2022 - 2025/2026**

Sipas grafikoni 1, ku janë paraqitur rastet e Influencës sezonale (ILI) në 5 sezonat e fundit shohim se sezona 2025/2026 karakterizohet me numër më të ulët të rasteve të raportura, krahasuar me periudhën e njejtë të sezonës 2024/2025 dhe fillim të aktivitetit nga java e 40-të e sezonës 2025/2026.

Grafikoni.1



**SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË, 2025/2026
DHE PRAGU EPIDEMIK**


Nga fillimi i sezonës, 29 shtator 2025 deri më 17 maj 2026 (java e 20-të) në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës janë raportuar 56,286 raste të Sëmundjes të ngjashme me Grip (ILI), 9,645 raste të Infeksioneve respiratore akute (ARI) dhe 260 raste me Infeksion të rëndë respirator akut (SARI).

Gjatë javës së 20-të (11.05.2026-17.05.2026) janë raportuar 761 raste ILI (Sëmundje e Ngjashme me Gripin), 57 raste ARI (Infeksion Respirator Akut) dhe 2 raste SARI (Infeksion i Rëndë Akut Respirator).

Përmes sistemit të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjytëse dhe paralajmërimit të hershëm (SMSN) janë raportuar 219 raste ILI, 23 raste ARI dhe 2 raste me SARI.


Intensiteti i Influencës sezonale sipas numrit të rasteve të raportuara për javën e 20-të paraqitet në aktivitetin e ulët të qarkullimit dhe krahasuar me javën e kaluar shënon rënie prej 2.6%. (Graf.2)


Grafikoni.2



Në grafikonin 3 shohim se në të gjitha komunat janë raportuar raste të dyshimta në Influencë dhe sipas numrit të rasteve të raportuara, numër më të lartë kanë komuna e Prishtinës, Mitrovicës, Pejës dhe Prizrenit ndërsa sipas Incidencës numër më të lartë të rasteve kanë komuna e Kamenicës dhe Suharekës.


Grafikoni.3





Në raport me distribuimin e rasteve sipas grup-moshës dhe incidencës, nga numri total i rasteve të raportuara me ILI, shihet se të gjitha grup-moshat janë të atakuara derisa sipas Incidencës; grup-mosha 0-4 dhe mbi 65 vjeç. Sa i përket rasteve me ARI, grup-mosha më e atakuar është 0-4 vjeç (6,872 raste) pastaj grup-mosha 5-14 vjeç (1,256 raste), 15-64 vjeç (1,028 raste), dhe grup-mosha 65+ vjeç (489 raste). (Graf.4)


Grafikoni.4



MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE


Në laboratorin e Qendrës Kombëtare të Influcencës – IKSHPK nga fillimi i sezonës 2025/2026 deri më 20 maj 2026, janë testuar gjithsej 4,671 mostra nga pacientët e qendrave sentinel dhe jo sentinel si raste të dyshimta në ILI, ARI dhe SARI. Nga mostrat e testuara 2,338 (50.1%) prej tyre të dyshimta në SARS-CoV-2 dhe 2,333 (49.9%) të dyshimta në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë. Gjatë kësaj periudhe në SARS-CoV-2 janë konfirmuar 21 raste (0.9%). Nga 2,333 mostrat e testuara në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë janë konfirmuar 335 raste me Influcencë A dhe B (pozitiviteti 14.4%), prej tyre 332 apo 99.1% me Influcencë A dhe 3 apo 0.9% me Influcencë B. Rastet e konfirmuara me Influcencë A dhe B janë nga komuna e Prishtinës (128 raste), Mitrovicë (58 raste), Fushë Kosovë (24 raste), Ferizaj (13 raste), Podujevë (14 raste), Malishevë (14 raste), Lipjan (12 raste), Vushtrri (10 raste), Drenas (8 raste), Kaçanik (6 raste), Skenderaj (6 raste), Gjakovë (5 raste), Viti (5 raste), Suharekë (5 raste), Gjilan (4 raste), Pejë (4 raste), Shtime (3 raste), Klinë (3 raste), Rahovec (2 raste), Graçanicë (2 raste), Kamenicë (2 raste), Prizren (2 raste) dhe me nga 1 rast komunat : Novobërdë dhe Obiliq dhe i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç (153 raste), 5-14 vjeç (87 raste), 15-34 vjeç (37 raste), 35-50 vjeç (15 raste), 51-64 vjeç (13 raste) dhe 65+ (30 raste). Gjatë javës së njëzetë (11.05.2026-17.05.2026), nga laboratorët private janë raportuar gjithsej 16 mostra të testuara si të dyshimta në SARS-CoV-2. Nga këto mostra nuk është konfirmuar asnjë rast pozitiv. Nga patogjenët tjerë respiratorë, janë konfirmuar: 271 mostra me RSV, 514 mostra me Human Rhinovirus, 219 mostra me Human Adenovirus, 89 mostra me Metapneumovirus dhe 80 mostra me Parainfluenza Virus (Graf.5). Rastet pozitive në RSV (11.6%), janë nga komuna e Prishtinës (97 raste), Fushë Kosovë (34 raste), Ferizaj (24 raste), Malishevë (15 raste), Podujevë (15 raste), Vushtrri (10 raste), Lipjan (8 raste), Drenas (7 raste), Obiliq (7 raste), Gjilan (6 raste), Suharekë (6 raste), Prizren (6 raste), Mitrovicë (5 raste), Viti (4 raste), Kaçanik (4 raste), Shtime (3 raste), Rahovec (3 raste), Hani i Elezit (2 raste), Kamenicë (2 raste), Klinë (2 raste), Deçan (2 raste), Pejë (2 raste) dhe me nga 1 rast komuna: Graçanicë, Gjakovë, Istog, Novobërdë dhe Skenderaj. Rastet pozitive me RSV i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç (231 raste), 5-14 (15 raste), 15-34 (5 raste), 35-50 (1 rast), 51-64 (2 rast) dhe 65+ (8 raste) (Graf.5).

Grafikoni.5



Sipas subtipit: me subtipin AH3: 32 mostra apo 10%, me subtipin AH1N1: 12 mostra apo 3%, Influcencë A të pa subtipizuar, 288 mostra apo 87% dhe Influcencë B, 3 raste apo 1%.(Graf.6.)

Grafikoni. 6



AKTIVITETET SEZONALE

IKSHPK/Departamenti i Epidemiologjisë bënë mbikëqyrjen e Influcencës gjatë tërë vitit, me intensifikim të saj gjatë sezonës përkatëse (java e 40 deri në javën e 20).

Përcjell situatën epidemiologjike me rastet ILI/ARI (javore) dhe rastet me SARI (në bazë ditore/alerti).

Bënë testimin laboratorik të mostrave në Departamentin e Mikrobiologjisë/Qendrën Kombëtare për Testimin e Influcencës.

Ka dhënë këshilla për popullatën për mbrojtjen nga sëmundja dhe njohjen e simptomeve të saj.

MASAT PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË VIRUSIT TË GRIPIT SEZONAL

Aktiviteti i gripit për sezonën 2025/2026, është në nivel më të ulët krahasuar me sezonën paraprake dhe masat për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve respiratore janë:

Mbajtja e maskave.

Distanca fizike.

Higjiena e duarve.

Evitimi i kontakteve të afërta me individë të sëmurë.

Redukimi i vizitave të familjarëve tek personat e hospitalizuar (SHSKUK, Spitalet rajonale).

Evitimi i vendeve të mbyllura dhe të mbingarkuara me njerëz.

Ushqimi i shëndetshëm me shumë vitamina.

Aktiviteti fizik dhe gjumë i mjaftueshëm.

Personat e sëmurë të qëndrojnë në shtëpi.

- Pastrimi dhe dezinfektimi i mjediseve ku qëndroni.
- Mbulimi i hundës dhe gojës me një shami gjatë teshtitjes dhe kollitjes si dhe hudhja më pas në vend të sigurt.
- Larja e duarve shpesh me ujë dhe sapun, ose solucione duarsh me alkool.
- Sytë, hunda dhe goja të mos preket me duar të kontaminuar, pasi virusi përhapet në këtë mënyrë.
- Pastrimi dhe dezinfektimi i sipërfaqeve dhe objekteve që mund të jenë kontaminuar nga virusi.

Konsultimi me mjekun për mjekimin me barna kundër gripit, të cilat duhet të merren vetëm me rekomandimin e mjekut

Medikamentet kundër gripit duhet të fillohen brenda 48 orëve të para të fillimit të sëmundjes për të pasur efektivitet të lartë.

Ato mund të parandalojnë edhe komplikimet e rënda që mund të vijnë nga gripit.

Mënyra më efikase për parandalimin e virusit të gripit është Vaksinimi me vaksinën kundër gripit.

- Vaksinimi mbron vetë personin dhe ndihmon në parandalimin e përhapjes së gripit.
- Efekti i vaksinës fillon 1 deri 2 javë pas marrjes dhe mbrojtja vazhdon rreth një vit pas vaksinimit.

VAKSINIMI

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me IKSHPK në fillim të sezonës së gripit 2025/2026 ka siguruar 85,000 doza të vaksinës sezonale dhe me fillimin e sezonës ka filluar vaksinimi sipas rekomandimeve. Deri më 31 janar 2026 janë administruar gjithsej 67,072 doza të vaksinës kundër gripit sezonal. Prej tyre sipas grupeve të rrezikut: 44,752 janë administruar te grup-mosha mbi 65 vjeç, 20,467 me sëmundje kronike, 1,300 profesionistë shëndetësor, 6 gra shtatëzëna, 49 fëmijë (0-5 vjeç), 195 zyrtarë policorë dhe 32 mësimdhënës dhe të tjerë 271.

HOSPITALIZIMET

Gjatë javës së fundit nga rastet e hospitalizuara në Klinikën Infektive, Klinikën e Pediatriisë dhe spitalet rajonale janë raportuar 26 raste me ARI, 3 raste me ILI dhe 2 raste SARI.

Nga Klinika Infektive deri më 17 maj 2026, janë raportuar 5 raste të vdekjes me Influcencë A. Tre nga rastet i përkasin gjinisë mashkullore dhe dy gjinisë femërore; 4 prej të cilëve i takojnë grup-moshës mbi 65 vjeç dhe një prej tyre grup-moshës 35-50 vjeç dhe me sëmundje kronike përcjellëse.

SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE NË RAJON DHE EVROPË**INFLUENCA SEZONALE JAVA 20/2026 NË EVROPË**

Gjatë javës së 19-të të vitit 2026, situata epidemiologjike e viruseve respiratore në Rajonin Evropian vazhdon të karakterizohet me aktivitet të ulët dhe kryesisht ndër-sezonal të Influcencës, SARS-CoV-2 dhe RSV. Të dhënat e mbikëqyrjes epidemiologjike dhe virologjike tregojnë se qarkullimi i viruseve respiratore mbetet stabil dhe nën pragjet epidemike në shumicën e vendeve të rajonit. Vetëm një numër i kufizuar shtetesh raportuan incidencë të rritur të sindromës së ngjashme me influencën (ILI) mbi nivelin bazal, ndërsa aktiviteti i rritur i infeksioneve akute respiratore (ARI) nuk u raportua në nivel rajonal. Pozitiviteti i Influcencës në sistemet sentinel të mbikëqyrjes ILI/ARI mbeti nën pragun epidemik prej 10%, duke reflektuar përfundimin gradual të sezonit respirator 2025/2026. Në kujdesin parësor shëndetësor vazhdoi të dominojë Influenca tip B, ndërsa në rastet e hospitalizuara me SARI u raportua predominim i Influcencës tip A, veçanërisht nën-tipi A(H3). Aktiviteti global i Influcencës ka shënuar rënie progresive krahasuar me muajt e dimrit, megjithëse në disa rajone të Azisë dhe në vende të veçanta vazhdojnë të raportohen nivele më të larta të pozitivitetit. Aktiviteti i SARS-CoV-2 mbeti në nivele bazale në të gjithë Rajonin Evropian, pa sinjale për rritje të konsiderueshme të transmetimit komunitar apo rritje të hospitalizimeve. Sistemet e integruara të mbikëqyrjes respiratore vazhdojnë të monitorojnë qarkullimin e varianteve të SARS-CoV-2, ndërsa shumica e vendeve raportojnë stabilizim të indikatorëve epidemiologjikë dhe virologjikë. Mortaliteti i lidhur me COVID-19 dhe mortaliteti total në vendet pjesëmarrëse të EuroMOMO mbetën brenda niveleve të pritshme sezonale për të gjitha grupmoshat. Qarkullimi i virusit RSV vazhdon të rikthehet gradualisht në nivele ndër-sezonale. Megjithatë, disa vende ende raportojnë aktivitet të moderuar të RSV, veçanërisht tek fëmijët nën 5 vjeç dhe grupet vulnerabël. Në mbikëqyrjen e rasteve të rënda respiratore (SARI), pozitiviteti për Influcencë, SARS-CoV-2 dhe RSV mbeti i ulët dhe relativisht stabil krahasuar me javët paraprahe, pa ndryshime të rëndësishme në trendet e hospitalizimeve apo rasteve në kujdes intensiv. Karakterizimi virologjik i viruseve të Influcencës gjatë sezonit 2025/2026 tregon dominim të nën-tipit A(H3), ndërsa një pjesë më e vogël e rasteve i përkisnin Influcencës B. Analizat antigjenike dhe gjenetike tregojnë se shumica e viruseve të karakterizuara mbeten të ngjashme me shtamet e përfshira në vaksinën sezonale aktuale. Për këtë arsye, rekomandimet e OBSH-së për përbërjen e vaksinës së Influcencës për hemisferën veriore për sezonin e ardhshëm mbeten të pandryshuara.

Burimi: <https://erviss.org/>